



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Agjencia Kosovare e Privatizimit shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedurë kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i Lartë Ekzekutiv
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	4-4
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	13/10/2022
Afati për aplikim	28/10/2022 - 04/11/2022
Institucioni	Agjencia Kosovare e Privatizimit
Departamenti	Zëvendës Drejtori Menaxhues - Likuidimi
Divizioni	
Vendi i punës	Profesional 1
Nr. i Referencës	RN00010170
Kodi	RPC0003869



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Koordinimi dhe menaxhimi i Zyrës së ZDM - likuidimi

- Organizon punët e stafit për të siguruar që struktura organizative e likuidimit vepron në mënyrë të saktë dhe efektive dhe i plotëson detyrat raportuese dhe të tjera brenda afatit;
- Cakton dhe ngarkon detyrat raportuese si dhe detyra tjera kurdo që kërkohet, në mënyrë të saktë dhe të përpiktë;
- Të bëj raportimin javor dhe ad-hoc tek Zëvendës Drejtori Menaxhues - likuidimi për ta informuar atë për aktivitetet dhe veprimtaritë e procesit të likuidimit;
- Të ndërmjetësoj me drejtuesit e Departamenteve dhe Njësive me qëllim që të siguroj që qëllimet dhe aktivitetet e ndërmarra nga Divizioni i Likuidimit të përputhen me aktivitetet e ndërmarra nga departamentet dhe njësitë e tjera;
- Të ndihmoj ZDM - likuidimi në përgatitjen, përmbushjen dhe funksionimin e buxhetit të Likuidimit të AKP-së;
- Është përgjegjës të siguroj se raportet përkatëse dhe detyrat e tjera që iu janë caktuar Likuidimit të kryhen brenda afatit të përcaktuar nga ZDM - likuidimi;
- Lidhur me procesin e likuidimit koordinon përgatitjen e Planit të Zbatimit të Rekomandimeve të Njësisë së Brendshme të Auditimit dhe monitoron zbatimin e këtij plani;
- Të kryej detyra tjera të përcaktuara nga Zëvendës Drejtori Menaxhues – Likuidimi.

Koordinimi me strukturat tjera të jashtme

- Punon në koordinim, përgatit raportet e kërkuara dhe merr pjesë në mbledhje me palë të ndryshme të strukturave të jashtme përfshirë këtu Qeverinë e Kosovës dhe Ministrinë përkatëse, Qeverisjet Komunale, agjencitë ndërkombëtare, OJQ-të vendase dhe ndërkombëtare, bankat vendase dhe ndërkombëtare, shoqatat e biznesit vendor dhe ndërkombëtar dhe organizatat tjera.

Ndërmjetësimi dhe Koordinimi

- Ndërmjetëson rregullisht me ZDM - likuidimi në çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e përgjithshëm të procesit të Likuidimit;
- Koordinon aktivitetet e zyrës së ZDM-likuidimi për mbarëvajtjen e projektit të likuidimit nga OSHP.



2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Diplomë Universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to në Ekonomik, Juridik, Menaxhment, Biznes apo në ndonjë fushë tjetër relevante me pozitën;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën relevante;

4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Shkathtësi organizative dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi ndër-personale dhe të komunikimit në ambientin e punës;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve dhe llogaridhënies;
- Njohuri të mirë të përdorimit të aplikacioneve të mëposhtme softuerike të pakos MS;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ ose serbe në të folur dhe shkruar. Njohja e gjuhës angleze e preferuar;
 - Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende
- Dëshmi nga Gjykata që nuk jeni nën hetime

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 11/11/2022, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- Zyra Qendrore AKP

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

Aftësi organizative dhe të menaxhimit të kohës;

- Shkathtësi ndër-personale dhe të komunikimit në ambientin e punës;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve dhe llogaridhënies;
- si dhe njohuri të kërkuara sipas pëshkrimit të detyrës së punës

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen



